

Winter 12-2014

PËRGJEGJËSITË E AUDITORËVE

Marigona Hargaja

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

PËRGJEGJËSITË E AUDITORËVE
SHKALLA BACHELOR

Marigona Hargaja

Dhjetor / 2014
Prishtinë



Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2011 – 2012

Marigona Hargaja

PËRGJEGJËSITË E AUDITORËVE

Mentori: Dr. Sc. Bukuriye Jusufi

Dhjetor/2014

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Auditimi është proces i sistematizuar i mbledhjes dhe krijimit të argumenteve mbi veprimtarinë ekonomike dhe rezultatet me qëllim që të konstatohet baraspesha në mes të raporteve të afarizmit dhe kriteriumeve të parashtruara dhe kjo tu dërgohet shfytëzuesve të interesuar. Auditimi është procedurë e të vërtetuarit dhe vlerësimit të raporteve financiare, poashtu është edhe procedurë e konsolidimit të raporteve financiare të obliguesve të auditimit të argumenteve dhe metodave të cilat zbatohen me rastin e përpilimit të raporteve financiare në bazë të të cilave jepet mendimi profesional dhe i pavarur mbi gjendjen reale dhe objektive financiare, rezultatëve financiare dhe rrjedhës së parasë.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Falënderoj familjen time për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë kohës së punimit të diplomës. Gjithashtu falënderoj prof. Bukurije Jusufi për instruksionet e dhëna për punimin e diplomës, dhe për gatishmërinë dhe kohën e gjetur për të më ndihmuar rreth çdo paqartësie që kam pasur gjatë punimit.

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE.....	4
1. HYRJE.....	5
2 SHQYRTIMILITERATURËS	6
2.1HISTORIKU I AUDITIMIT	6
2.1.1 Klasifikimi i Auditimit	7
2.1.2 Audimi i Brendshëm.....	9
2.1.3 Auditimi i Jashtëm.....	11
2.1.4 Auditimi Shtetrorë	12
2.1.5 Auditimi Komercial.....	13
2.2 STANDARTET E AUDITIMIT.....	14
2.2.1 Trajnimi i Auditorëve	14
2.2.2 Kriteret për Auditor	15
2.2.3 Detyrat e Auditorëve	15
2.2.4 Sanksionet.....	16
2.2.5 Etika Profesional	17
2.2.6 Përgjesitë e Auditorëve.....	19
2.2.7 Konflikt Interesi i Auditorëve	21
2.2.8 Të Drejtat e Auditorëve	211
2.2.9 Kufizimet e Auditorëve	22
2.3 STANDARTET E AUDITIMIT NË VEND.....	23
2.3.1 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	23
2.3.2 Auditori i Përgjithshëm i Kosovës.....	253
2.3.3 Firmat e Auditimit	25
2.3.4 Kushtet e Përgjithshme.....	25
2.3.5 Firmat e Certifikimit të Auditorëve	27
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	Error! Bookmark not defined.
4METODOLIGJIA	29
5 REZULTATET	30
5.1 Raporti i Auditimit.....	30
6 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME	30
7 REFERENCAT.....	332

FJALORI I TERMAVE

CPA -Firmat e certifikuara të kontabilitetit, (Certified public accountants firms).

AQBK- Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës.

SNA - Standartet Ndërkombtare të Auditimit.

IFAC- Federata Internacionale e Kontabilitetit,(International Federation of Accountants).

ZAP – Zyra e Auditorit te Përgjithshëm.

INTOSAI – Organizata Ndërkombtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.

1.HYRJE

Auditimi është një proces i sistemuar, i objektivizuar i mbledhjes dhe krijimit të të dhënave mbi ndodhitë ekonomike dhe në rezultatet me qëllim që të hulumtohet dhe vlerësohet përputhshmëria në mes të afarizmit egzistues pastaj të raporteve financiare me kriteriumet e përcaktuara më parë. Gjatë auditimit të pasqyrave financiare, auditorët angazhohen rreth sigurimit të evidencës së mjaftueshme të auditimit dhe ofrojnë nivel të lartë të sigurisë që pasqyrat financiare janë në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit (GAAP), ose standarde tjera të pranueshme të kontabilitetit.¹

Auditimi përfshinë kërkimin dhe verifikimin e të dhënave kontabël dhe ekzaminimin e evidencave (fakteve) tjera të cilat i mbështesin informatat e prezantuara në pasqyra financiare. Duke mbledhur informata lidhur me kompaninë dhe mjedisin në të cilin ajo vepron, përfshirë kontrollet e brendshme, inspektimin e dokumenteve, vëzhgimin e pasurive, marrjen e personave brenda dhe jashtë kompanisë në intervistë, dhe kryerjen e procedurave tjera të auditimit, do të mbledhin evidencë të nevojshme për ta lëshuar opinionin e auditimit. Raporti i auditimit konstaton që sipas opinionit të auditorit pasqyrat financiare janë në përputhje me parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit.²

“Auditim” do të thotë një ekzaminim i pajtueshmërisë ose performancës ligjore dhe financiare që kryhet nga eksperti për të plotësuar kërkesat e menaxhmentit (auditimi i brendshëm) apo nga një entitet i auditimit të jashtëm ose nga një auditor tjetër i pavarur për të përmbushur obligimet e caktuara me ligj (auditimi i jashtëm).³

¹Shefket Jakupi, Hidajet Shehu “Kontrolli dhe Revizioni i Proceseve Afariste në Ndërmarrje” (Prishtinë 2011) f.16

²Bukurije Jusufi “Auditim dhe Kontroll” ligj. (Prishtinë 2012)

³[http://www.kryeministri-](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROJEKTLIGJI_PER_AUDITORIN_E_PERGJITHSHEM_DHE_ZYREN_KOMBE_TARE_TE_AUDITIMIT_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES.pdf)

[ks.net/repository/docs/PROJEKTLIGJI_PER_AUDITORIN_E_PERGJITHSHEM_DHE_ZYREN_KOMBE_TARE_TE_AUDITIMIT_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROJEKTLIGJI_PER_AUDITORIN_E_PERGJITHSHEM_DHE_ZYREN_KOMBE_TARE_TE_AUDITIMIT_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES.pdf)Neni 1.1

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Historiku i Auditimi

Fjala auditim rrjedh prej fjalës latine “audire” që do të thotë dëgjim, pra të dëgjosh, kuptimi i saj lidhet kryesisht me epoka shumë të largëta lidhur me dëgjimin dhe gjykimin. Kuptimi original i auditorishte “ai që dëgjon” dhe ishte i përshtatshëm për atë etapë kohore gjatë së cilës të dhënat e kontabilitetit të qeverisë janë aprovuar vetëm pas dëgjimit nga ana e publikut me ç’rast llogaritë e kontabilitetit janë lexuar me zë. Termi auditim shpesh për përdoret vetëm shpesh i bashkëshoqëruar nga një mbiemër (audit i brendëshem , audit financiar), shpesh e një specifikim (audit i ciliësise, audit i sistemeve informative), shpesh herë i përkthyer si "revizion" por edhe si "verifikim", disa herë si "kontroll" ose "monitorim. Në vendet anglishtë folse përdoret termi "auditor"(revizor) auditing(revizion). Auditimi është zhvilluar në vendet anglishtë folëse sepse kishin një zhvillimi të lartë ekonomik.

Tregjet e para të shënuara të auditimit në Britanin e Madhe datojnë në vitin 1130. Referimet e para të termit auditing gjenden në Angli që nga viti 1300, atëher kur u krijua figura e "Auditorit të shtetit", zyrtar publik i ngarkuar për të kontrolluar shërbimet publike. Më pas në vitin 1559, nën drejtimin e Mbretërisë Elisabeta I, u themeluan institutet e "Auditorëve të shtetit" përgjegjës zyrtar të kontrollit të pagesave ndaj shtetit (të zëvendësuar me 1780 nga "Komisarët për Auditimin e shpenzimeve të shtetit"). Në këtë kuptim fjala "auditor-auditues", përdoret për të treguar atë që kontrollon dhe verifikon, ndërsa "auditing-audit" funksionin e kontrollit të ushtruar nga ky subjekt.⁴

Auditimi në të hyrat dhe shpenzimet e drejtorive të qytetit dhe është kryer nga administratorët e shtetit. Ku të gjithë administratorët e parasë publike do të auditohen nga audituesit. Auditimi kryhet sipas SNA-së duke respektuar Kodin e Etikes Profesionale të audituesit. Raporti i auditimit me mendimin e shprehur bazohet në të dhënat objektive dhe u dorëzohet shfrytëzuesve të interesuar. Raporti i audituesit mbi objektivitetin dhe

⁴Shefket Jakupi, Fadil Krasniqi “Auditim” (Prishtinë 2012) f.61

realitetini ofrohet publikut. Këto standarte janë përafersisht edhe sot. Pra auditimi konsiderohet si "lidhje e cila krijnë besim".

Auditimi është term administrative me të cilin nënkuptohet procesi që mund të realizohen për të kënaqur kërkesat e menaxhimit, apo të një auditori tjetër të pavarur, për të plotësuar obligimet statusore. Auditimi nuk është gjë tjetër vetëm së hulumtimi i raporteve financiare, të dhëna mbi afarizmin, librave afariste dhe dokumentacionin tjetër me qëllim të marrjes së mendimit të besueshëm mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të klientit.

Auditimi është një proces sistematik i grumbullimit dhe vlersimit objektiv të fakteve në lidhje me vërtetimet mbi veprimet dhe ngjarjet ekonomike për të siguruar shkallën e korrespondences midis vërtetimeve dhe kriterëve të përcaktuara dhe komunikimit të rezultateve për përdoruesit e interesuar.

Auditimi nuk është një proces i paplanifikuar, i pastrukturuar dhe i rastit. Kur fillohet një procedur e auditimit, audituesit të pavarur i jepen pasqyrat financiare dhe raportimet e tjera nga drejtuesit dhe kështu grumbullohen vërtetimet e drejtpërdrejta të drejtuesve për veprimet dhe ngjarjet ekonomike. Audituesit e pavarur përgjesisht e fillojnë punën me deklaratimet e drejtpërdrejta të drejtuesve që janë vërtetimet e shifrave të pasqyrave financiare dhe informacioni që përmbahet tek shënimet. Me pas ato organizohen për të grumbulluar fakte që provojnë ose jo këto deklarime.⁵

2.1.1 Klasifikimi i Auditimit

Sipas mënyres së organizimit

- Te brendshëm
- Te jashtëm

Në lidhje me rregullat

- Të detyrueshëm
- Me dëshirë

⁵Shefket Jakupi, Hidajet Shehu "Kontrolli dhe Revizioni i Proceseve Afariste në Ndërmarrje" (Prishtinë 2011)

Në lidhje me llojin e ndërmarrjes

- Publike
- Private
- Jo profitabile

Në lidhje me fushat e administrimit

- Fiskale
- Organiative
- Sociale
- Te cilësis
- Informatike
- Kontabile (Bilanci)
 - Të plotë
 - Të pjesëshme⁶

Auditimi i pasqyrave financiare (ang. Financial Statements Audits)

Është procedurë e hulumtimit dhe vlerësimit të realitetit dhe objektivitetit të pasqyrave financiare. Kriteret për vlerësimin e objektivitetit dhe realitetit të pasqyrave financiare janë zakonisht dispozitat ligjore , pastaj principet e kontabilitetit dhe standardet e kontabilitetit.

Auditim i pajtueshmërisë të aktiviteteve (ang Compliance Audits)

Përcakton shkallën deri në të cilën entiteti i reviduar i ndjek standardet ose rregullat e caktuara, të krijuara ose të sjella nga autoritetet më të larta, përgjegjësit, rregullativa ligjore ose pajtueshmëri e shkruar.

Auditimi gjatë punës Auditimi i afarizmit(ang. Operational Audits)

⁶ Vjollca Karapici Ibrahimimi “*Auditim*” (Prishintw 2009) f.35

Prezanton hulumtimin dhe vlerësimin e afarizmit të përgjithshëm të ndërmarrjes (apo pjesëve të afarizmit) me qëllim të prosperimit të afarizmit të ndërmarrjes si dhe të suksesit të afarizmit (para se gjithash mendohet në rentabilitet).

Auditimi gjyqësor (ang.Forensic Audits)

Duhet të zbuloj ose parandaloj aktivitetet që kanë si pasojë mashtrimet ose aktivitete të tjera jolegale, të integruar në raportet financiare të ndërmarrjes klient.⁷

2.1.2 Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është pjesë integrale e sistemit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë, ndonse kontrolli i brendshëm është me i gjerë në qëllim dhe përmbajtje. Ai synon të shtojë vlera dhe të përmirsojë aktivitetin e shoqërisë. Ai ndihmon shoqërinë të arrijë objektivat e saj nëpërmjet futjes së një trajtimi sistematik, të dëbuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të riskut, kontrollin dhe proceset e qeverisjes së korporatave. Auditimin e brendshëm bëjnë organet përkatëse të punësuar brenda ndërmarrjes, të cilët e njohin mirë veprimtarinë e ndërmarrjes, dhe është mbështetje kryesore e mbikqyrjes së jashtme dhe revizionit. Auditimi i brendshëm rishikon dhe siguron besueshmërinë dhe integritetin e informacionit, përputhjen me politikat dhe rregullat, ruajtjen e pasurive, përdorimin ekonomik dhe efikas të burimeve si dhe arrijnë e synimeve operacionale dhe të objektivave. Auditimi i brendshëm është veprimtaria e pavarur që siguron menaxhimin dhe këshillon veprimtarin drejtues, për përdorim efektiv të fondeve dhe përmirësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara duke i ndimuar ato në mënyrë sistematike dhe të programuar, për përmirësimin e përdorimit efektiv të fondeve dhe për të vlerësuar riskun, performancën, sistemet e kontrollit dhe ato të drejtimit. Auditues i brendshëm, që në vijim do të quhet "auditues", dhe profesionist, i kualifikuar sipas kërkesave të përcaktuara me ligj. Objekti i punës së auditimit të brendshëm janë të gjitha

⁷Bukurije Jusufi "Auditim dhe Kontroll" ligj. (Prishtinë 2012)

vendimet financiare, për të ardhurat shpenzimet , administratimin e pasurive (aseteve) dhe borxheve. Auditimi i brendshëm si një proces dhe veprimari e pavarur nga pikpamja funksionale, vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të mbrendshëm.⁸

Auditimet e Brendshme Përfshijnë

Aktivitetin financiar dhe operacional të sistemeve

Prodhimin

Marketingun

Burimet Njëzore dhe

Gjithqka tjetër në shoqëri.

Në përfundime të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozon masa, për të përmirësuar funksionimin dhe drejtimin e subjekteve të audituara.Sa më shumë transformohen mardhëniet profesionale dhe shëndërrohen në mardhënie shoqërore(miqësore), rritet rreziku i mungesës së drejtësisë dhe objektivitetit.Për të funksionuar siq duhet auditimi i brendshëm duhet të gëzoje një shkallë të pranuar të arsyeshme pavarësie, kjo mund te realizohet duke bërë atë qëtë jep llogari para bordit të drejtorëve, në të kundërten do të humbte shumë nga funksioni i tij.⁹

Pasqyrat financiare që auditohen janë:

- Bilanci i gjendjes
- Bilanci i suksesit (pasqyra e të ardhurave)
- Rrjedha e parasë
- Pasqyr e ndryshimeve në ekuitet.

⁸Shefket Jakupi,Fadil Krasniqi “*Auditim*”(Prishtinë 2012) 80

⁹Bukurije Jusufi “*Auditim dhe Kontroll*” ligj. (Prishtinë 2012)

Në bazë të organit që kryen hulumtimin (revidimin):

- auditimekstern
- auditim intern

2.1.3 Auditimi i Jashtëm

Objekt i auditimit të jashtëm më së shpeshti janë pasqyrat financiare të njësive ekonomike. Auditimi bëhet që të shikohet se a janë ndërtuar në mënyrë reale, të sinqert dhe objektive pasqyrat financiare në bazë të parimeve dhe standarteve të kontabilitetit, standartet mbi raportin financiar, dispozita ligjore dhe politikat e miratuara kontabël nga klienti të cilit i është bërë auditimi, nëse pasqyrat financiare janë ndërtuar në bazë të kriterëve të lartë përmendura, atëher audituesi në raportin e tij mund të deklarojë se pasqyrat financiare janë reale dhe objektive. Ky veprim edhe mbështetur në standartet e auditimit, në kodin e etikes profesionale dhe në pozitat ligjore. Zakonisht auditimin e jashtëm e kryejn kompanit audituese dhe audituesit e autorizuar të cilët janë të certifikuara nga institucionet profesionale përkatëse. Është thelbësore që puna e cila bëhet nga audituesit e jashtëm të mos zhvlerësohet nga ndonjë konflikt interesi faktik apo i mundshëm me qëllim që të jetë një opinion i besueshëm për aksionarët dhe palët e tjera të interesuara.

Roli dhe Veprimtaria e Auditorit të Jashtëm

Kontrolli i jashtëm nuk konsiderohet tani vetëm si profesion, por është shëndërruar në një post të lartë të një funksioni. Morali i fortë dhe i përsosur së bashku me karakterin e kompletuar përbëjnë cilësinë parësore për të gjithë revizorët e jashtëm, sepse veçoria dhe rëndësia e funksionit të tyre mund të barazohet me atë të gjyqtarit. Shoqëria e zhvilluar rëndësi të veçantë i jep sjelljeve profesionale. Koncepti profesional nënkupton përgjegjësinë për sjellje që ofrohte në përgjegjësisë ndaj vetvetes, dhe kërkesave ligjore e dispozitave shoqërore. Nëse profesioni zhvillon dhe respekton standard të larta të sjelljeve profesionale, etike dhe dhënies së shërbimeve, besimi i opinionit në kualitetin e atyre shërbimeve nuk do të mungojë. Për dallim nga profesione tjera, profesioni i auditorit ndaj

shfrytëzuesve të raportve financiare janë në pozitë të veçantë. Auditori është i paguar prej klientit i cili publikon raporte financiare, ndërsa shfrytëzues të raporteve të auditimit janë grupe të shumta të interesit të cilat në bazë të tij marrin vendime afrieste.

Cilësit të auditorit të jashtëm:

- Nivel të lartë njohurish të specializuara.
- Përvojë nga punësimi afatgjatë i tyre me probleme të ndryshme kontrolli.
- Aftësi të zhvilluar për tu bërë kritikë dhe për të kuptuar, pa ndërmjetësi dhe pa humbur kohë.
- Zgjuarsia dhe prirja për të planizuar dhe kuptuar metodat dhe procedurat e reja.
- Siguri dhe vetëveprim për drejtësinë e punës së tij.
- Zgjuarsi, diplomaci dhe dallueshmëri në kontaktet me personat e tjerë.
- Punë durim dhe studim në veprën e tij të zgjuar, përjashtim të zgjidhjeve kompromituese.¹⁰

2.1.4 Auditimi Shtetrorë

Mund të definohet si hetimi i dokumentëve, sistemit të kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm, veprimet kontabile dhe financiare, evidencimet e tjera që tregojnë se pasqyrat financiare janë reale dhe të besueshme dhe rezultatet e aktiviteve financiare janë në pajtueshmëri me parimet dhe standartet e kontabilitetit, procedurat kontabël dhe financiare nga aspekti i vërtetësisë dhe objektivitetit, si dhe rezultatet nga aktiviteti financiar, të hyrave, shpenzimeve, transaksioneve të njësisë në sektorin shtetërorë, njësisë lokale, kompanive publike, shfrytëzimin e mjeteve të Bashkimit Evropian në përputhshmëri me standartet kontabël dhe standartet e revizionit. Kryhet në emër të shtetit dhe në llogari të shtetit, këtë lloj të auditimit e kryen zyra e shtetit për auditim. Kjo nënkupton që zyra e

¹⁰Shefket Jakupi, Fadil Krasniqi "Auditim" (Prishtinë 2012) f.87

shtetit për auditim është eksterne e pavarur, pra është zyre profesionale e cila mbështetet mbi ligjin e auditimit shtetrorë.

Objekti i këtij lloji të auditimit janë:

- Mjetet për ndërmarrjet publike
- Mjete e huazimeve publike
- Mjetet e solidaritetit
- Mjete tjera të mledhura dhe destinuara për nevoja publike.

2.1.5 Auditimi Komercial

Njihet edhe si Auditimi ekstern kryhet në bazë të kontratës e cila lidhet në mes të obliguesit të auditimit dhe kompanisë e cila mirrët me auditim, kontrata lidhet me shkrim për çdo vit. Me këtë kontratë rregullohen marrëdhëniet ndërmjet vete si dhe kushtet e pagesës.

2.2 STANDARTET E AUDITIMIT

2.2.1 Trajnimi i Auditorëve

Te gjithë audituesit në detyre , sipas kriterëve të vendosura me ligj, i nënshtrohen edukimit të përditësuar dhe trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm , të cilat programohen dhe menaxhohen nga drejtoria e përgjithshme e auditimit. Komisioni i kualifikimit , si njësi përgjegjëse për kualifikimin dhe certifikimin e audituesve të brendshëm, krijohet me vendim të keshillit të ministrave , me porozim të ministrit të financave. Në vendim të përcaktohet rregulla e funksionimit dhe shpërbilimi i anëtarëve të kësaj njësie.

2.2.2 Kriteret për Auditor

Qeshtja më rëndësishme për kontrollin profesional janë kuadrot, dy kushtet që patjetër duhet të plotësojnë janë:

- Të kenë duart e pastërta dhe
- Të kenë mendjën e kthjellët.

Keto dy kërkesa edhe pse të thena në mënyrë metaforike, falasin shumë. Duke shikuar nga aspekti i njohurive duhet të di se paku ai të cilin e kontrollon. Disa autorë madje përcaktojnë dhe kriterë speciale për zgjedhjen e kontrollit.

Sipas tyre keto kriterë duhet të klasifikohen në tri grupe:

- Trupore
- Karaktere dhe
- Profesionale

Kriterë trupore (fizike)

- Rezistueshmëria
- Qëndrueshmëria.
- Kontrollori duhet të ketë nervat e mira
- Sy të shëndoshe
- Degjim të mirë etj.

Kriteret karaktere

- Ndjenja e pergjegjesis
- Siguria ne punet profesionale
- Ndersheria
- Sinqeriteti
- Objektiviteti
- Zotësia qe ti pranoje kritikak e arsyshme etj.

Kriteret profesionale

Kujdesi, mbajtja ne mend te numrave dhe te ngjarjeve, te menduarit e logjikshem, te kuptuarit qenesor, begatia e ideve, talenit per organizim, zoterimi i teknikes se punes, afersia e te shprehurit me goje dhe me shkrim,etj. Per te konkretizuar sa me shume punen e sherbimit profesional te kontrollit si dhe per te objektivizuar sa me shume punen e kontrollit duhet hartuar rregullorja e punes.¹¹

2.2.3 Detyrat e Auditorëve

Auditoret duhet te egzekutojne auditimet sipas gjykimit te tyre me te mire perfshire vlersimin e errezikut, qe paraqet perfshirjen e informatave te gabuara ne llogarite vjetore per shkake te parregullsise dhe gabimeve. Auditoret duhet te sigurojneë qe posedojne nje baze adekuate per te vlersuar nese eshte bere ndonje shkelje e rregulloreve dhe rregullave te AQBK-se, te cilat jane domethense sa i perket llogarive vjetore.

Auditoret duhet ti paraqesin me shkrim, menaxhentit te institucioneve financiare:

- Mangesit ne lidhje me detyrimin per te siguruar rexhistrimin e duhur, dhe shpalosjen e qarte dhe dokumentimin e informatave kontabel.
- Gabimet dhe mangesite ne organizimin dhe kontrollin e menagjimit te mjeteve.

¹¹Shefket Jakupi,Fadil Krasniqi “*Auditim*”(Prishtinë 2012) f.155

- Parregullsite dhe gabimet q emund te shkaktojne informimin e gabuar ne llogarite vjetore.
- Rrethanat q emund te shkaktojne detyrimet e antareve te bordit, asambleve te korporatave, koiteteve te perfaqesuesve te aksionareve apo menagjereve te pergjithshem.

Auditorët duhet të jenë në gjendje për të dokumentuar mjaftueshëm se si është kryer një auditim, si dhe rezultatet e një auditimi kurse parregullsite dhe gabimet që mund të jenë të pranueshme duhet të dokumentohen veqmas.

Auditorët dhe bashkëpunëtorët e auditoreve kanë për detyrë të ruajnë fshehtësitë profesionale, s ai përket çfarë do njohurive të përfituara gjatë kohës së aktivitetëve të tyre.

Auditorët dhe bashkëpunëtorët e tyre nuk mund të shfrytëzojnë ato informata për aktivitetet e veta apo për shërbim apo punësim të tjerëve.

Fshëtesija profesionale, do të vazhdojë të respektohet perseri edhe pasi që të ketë përfunduar detyra e tillë.¹²

2.2.4 Sanksionet

Nëse auditorët e institucioneve financiare i kanë shkelur detyrat e auditorit, të përcaktuara me këtë rregull dhe me rregulloret përkatëse AQBK, AQBK-ja mund të jepë auditorit një vërejtje, varesisht nga natyra e shkeljes së rregulloreve.

Nëse auditorët e institucioneve financiare në mënyrë të ashpër apo të perseritur i kanë shkelur detyrat e përcaktuara të auditorit të AQBK-së, mund të vijë deri të teheqja e aprovimit si auditor i një institucioni financiar.

¹²Shefket Jakupi, Fadil Krasniqi "Auditim" (Prishtinë 2012) f.136

2.2.5 Etika Profesional

”Nese nuk flitet per etiken e Auditorit, për tjetër as që vlen të flitet, sepse mos respektimi i etikës profesionale është burimi i të keqijave sot në botë”.

Etika (nga greqishtja ethos- doke, shprehi, karakter)shkenca mbi moralin, thelbin e etikës e përmbajnë vlerat me të cilat përshkruhet gjendja dhe sjelljet e dëshiruara.Etika si koncept përfshinë parimet dhe standartet e sjelljes njerzore, shpeshher te njohura dhe me fjalen Moral dhe mandje nga kjo e fundit dhe me studimin e parimeve etike eshte marre filozofija morale.Etika profesionale është zbatimi i parimeve të përgjithshme etike dhe rregullave për zgjedhjen e problemeve specifike të grupeve të ndryshme në shoqëri, respektivisht në definimin e rregullave të sjelljes së profesionit.¹³

Kodeksi i etikës së kontabilistëve profesional të IAEK-ut,Me kodeks përcaktohen standartet për sjellje profesionale, dhe njëkohësisht edhe formohen principet fundamenatale të cilët revizorët dhe kontabilistët duhet ti respektojnë që të mundën të ballafaqohen me publikun.¹⁴

Fjala etike ne perdorimin e perditshem a kuptime te ndryshme

- Parimet qe drejtone sjelljet e nje individi ose grupi te caktuar individesh.
- Etike personale.
- Etike profesionale

Keto rregullohen me kodin e etikës profesionale qe pergadisnin shoqatat perkatese profesionale, ku përcaktohen angazhimet e organizaten ne parimet si:

- Pavorsi
- Obektivitet
- Integritet

¹³Shefket Jakupi,Fadil Krasniqi “*Auditim*”(Prishtinë 2012) f.134

¹⁴Bukurije Jusufi “*Auditim dhe Kontroll*” ligj. (Prishtinë 2012)

- Konfidencialitet
- Kredibilitet
- Besueshmeri
- Profesionaliem

Ne kodin e mirsjelljes profesionale jane dhene parimet baze, te cilat i pergjithsojme ne 3 pjese

- Çmuarja- kontabilisti duhet te jete i sinqert, i drejt, i ndershem.
- Objektivi- ne paraqiten e informatave, ti ike konfliktit te interesave.
- Te kete aftesi profesionale
- Te jete i besueshem
- Te kete sjellje profesionale
- Te respektoje standartet e kontabilitetit

Si parime të natyrshme të profesionit ekspert kontabël janë:

- Pavarësia
- Ndreshmëri dhe objektivitet
- Kompetence profesionale dhe standarde teknike
- Përgjegjësi ndaj klientëve të tij
- Përgjegjësi ndaj kolegëve të vet
- Përgjegjësi të tjera dhe praktikë profesionale

Shkeljet civile:

- Shkelje të marrveshjes
- Falsifikim
- Indiferentizëm – kemi indiferentizëm i lehtë dhe i theksur

2.2.6Përgjegjësit e Auditorëve

Ofrimi I shërbimeve klientit kërkohet që kontabilisti të pranojë përgjegjësinë për kryerjen e atyre shërbimeve me integritet dhe objektivitet. Kontabilistë i ka të drejtë kompensim në të holla për kryerjen e shërbimeve të cilat duhej pasqyruar vlerën e atyre shërbimeve. Kompensimi llogaritet në bazë të çmimit në orë ose ditës së punës të secilit person të përfshirë në auditim (shpenzimet e tjera veçmas llogariten). Paga dhe marrja e provizionit nga ana e kontabilistit public auditorit nuk është e lejuar.

Përgjegjësia ndaj kolegëve përfëshin përgjegjësinë ndaj kontabilistëve të tjerë professional, reklamimin dhe kërkimin e punës, aktivitete të cilat janë të pabashkueshme me praktikën.

Raporti ndaj kontabilistëve të tjerë profesionist, nëse kontabilisti I cili është angazhuar nga ana e klientit nuk mundet në mënyrë të pavarur të kryej shërbime profesionale, është e mundur angazhimi I një kontabilisti tjetër professional. Raporti në mes njërit dhe tjetrit kontabilist është përkufizuar me kodeks etik dhe nënkuptohet bashkëpunimin dhe definimin e qartë të rolit të tyre.¹⁵

Përgjegjësia ndaj kolegëve: reklamimi dhe kërkimi I punës nga ana e kontabilistit profesionist në disa vende është I lejuar dhe në disa vende I ndaluar. Nëse është I lejuar ai duhet të udhëhiqet në mënyrë që mirsjellja, sinqeriteti e vërteta të jetë në kufijtë e shijes së mire.Siaktivitete të pabashkueshme me praktikën, kontabilisti profesional nuk do të guxonte të merrej me aktivitetet të cilat e shkatrojnë integritetin e tij, objektivitetin dhe pavarësinë ose reputacionin e mire të profesionit.

Përgjegjësia ligjore- kontabilistët profesionist mund të jenë me ligj përgjegjës, përkatsisht klientët ose ndonjë subjekt tjetër I interesuar mund ti padisë për shkak të demit të shkaktuar. Firmat e auditimit e kan sigurimin kundër përgjegjësive profesionale. Koncepti I drejtë në të cilin themelohet përgjegjësia e mundshme e auditorit është mjaft e komplikuar dhe e shumnumërt (pakujaesia e zakonshme, pakujaesia serioze, falsifikim I të dhënave I paqëllimshëm, shkelje e kontratave tjera etj).

¹⁵Bukurije Jusufi “*Auditim dhe Kontroll*” ligj. (Prishtinë 2012)

Përgjegjësitë e revizorit në raport me mashtrimet në auditimin e raporteve financiare.
Përgjegjësitë profesionale të revizorëve në zbulimin e mashtrimeve dhe gabimeve.¹⁶

Burime potenciale mashtrimesh:

- Aksionerët
- Kreditorët
- Konkurentët
- Komitentët
- Qeveria
- Të siguruarit, të punësuarit etj.

Ekzistojnë katër lloje të motiveve për mashtrime:

- Psikologjike
- Egocentrike
- Ideologjike
- Ekonomike
- Parandalimi i mashtrimeve

Akti i mashtrimit kalon nëpër disa etapa:

- Të menduarit e mashtrimit dhe përpilimin e planit
- Realizimi i idesë në vepër
- Konvertimi në dobi të tyre
- Mbulimi i gjurmëve nga vepra e kryer

¹⁶Shefket Jakupi, Fadil Krasniqi "Auditim" (Prishtinë 2012) f.149

2.2.7 Konflikt Interesi i Auditorëve

Audituesi njofton paraprakisht, me shkrim, drejtuesin e njesise se auditimit te brendeshem per qdo konflikt te mundeshem interesi, qe rrjedh nga pjesemarrja e tij ne auditimin e nje subjekti.

Me konflikt interesash kuptohet:

- Punesuar si auditues gjate 3 viteve te fundit te subjektin, qe do te auditohet.
- Punesimi ne funksione drejtuese gjate 3 viteve te fundit te subjektit, qe do te auditohet, tek audituesi, bashkeshortes/bashkeshortit, te afermeve me lidhje gjinie deri ne shkallen e dyte, sipas percaktimeve te bera ne Kodin Civil.
- Zoterimi nga audituesit, bashkeshorteja/bashkeshorti, te afermit me lidhje gjinie deri ne shkallen e trete, sipas percaktimeve te bera ne Kodin Civil te aksioneve ose pjeseve te kapitalit ne subjektin publik qe do te auditohet.

2.2.8 Të Drejtat e Auditorëve

Audituesit ne kryerjen e misionit te tyre kane te drejtat e meposhtme:

- Te ushtrojne ne menyre te pavaruar funksionin e auditimit, pa lene hapsire per nderhyrje nga koleget, mbikqyresit, drejtuesit e njesive se auditimit ose pala e audituar, me perjashtim te marrdhenjeve te ndersjellta te keshillimit.
- Te kerkojne te gjitha te dhenat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe te drejtimit te subjektit qe auditohet, duke marre persiper ruajten e fshetesis se tyre, sipas legjislacionit ne fuqi.
- Te marrin nga punjesit e subjektit te audituar, per raste qe gjykohet e nevojshme, shpjegime dhe deklarata, fotokopje te dokumenteve, ne te cilat drejtuesi i subjektit te audituar vene shenim'' e njejte me origjinalin'' si dhe materiale te transportueshme ne forme elektronike qe kane lidhje me auditimin e brendshem te subjektit.

- Te ndjekin ne menyre periodike edukimin e perditesuar dhe trajnimin e nenit 20 te ketij ligji per funksionet e veqanta, qe ushtrone edhe si ne fushat e tjera brenda sherbimit.
- T'i paraqesin kerkesat drejtuesit te njesis se auditmimit, kur cmojme se per shkaqe te argumetuara cenohet besueshmeria dhe cilesia e auditimit

2.2.9 Kufizimet e Auditorëve

Audituesve u ndalohe:

- Te jene te zgjedhur ne funksionet drejtuese ne strukturat e partive politike.
- Te kryjne detyrat , brenda subjektit te audituar , qe nuk kane te bejneme funksionimin e auditmit te brendeshem ne sektorin publik.
- Te ushtroje qdo veprimtari ose pune tjeter me pagese , ose te kene perfitime tjera , te natyrav dhe formav , qe i bejne te jete ne konflik interesash me ushtrimin e auditmimit.

2.3 STANDARTET E AUDITIMIT NË VEND

2.3.1 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Zyra e auditorit ka një rol vendimtar në ngritjen e besimit publik në këtë sektorë i cili është ende duke u zhvilluar dhe është jetësore që të krijohet një standart sa më i lartë i auditimit në mënyrë që të sigurohet besueshmëria e pasqyrave financiare që i paraqiten nga ana e tyre. Kjo zyrë drejtohet nga praktika më e mirë ndërkombtare duke i miratuar edhe formalishtë standartet e nga INTOSAI e cila e jep kornizën në bazë të së cilës duhet të veprojmë, përmes zbatimit të këtyre standarteve në kemi mundësinë që të jemi organizatë shembull.¹⁷ Qëllimi i një auditimi është rritja e shkallës së besimit për shfrytëzuesin e caktuar në pasqyrat financiare e ky do të rritet vetëm nëse rezultatet tona janë të paraqitura qartë dhe në mënyrë logjike të mbështetura në dëshmi dhe të kryera sipas standarteve ndërkombtare të pranuar.¹⁸

2.3.2 AUDITORI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS

- Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollitekonomik e financiar.
- Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj.
- Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.
- Kuvendi vendos për shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të

¹⁷www.oag-rks.org/repository/docs/Code_of_Ethics_and_Auditing_Standards_-ONTOSAI_970836.pdf, 25

¹⁸http://www.oag-rks.org/repository/docs/Manuali_i_auditimit_te_Rregullise_149287.PDF, 8

propozimit të Presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- Mandati i Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.¹⁹

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon

- Veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë Shtetërorë,
- Përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe Lokal,
- Veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tektë cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.²⁰

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Kuvendit i paraqet:

- Raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit,
- Mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi,
- Informacione për rezultatet e kontrolleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
- Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës i paraqet Kuvendit raportin vjetor përveprimtarinë e vet.²¹

¹⁹http://www.oag-rks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves_549744.pdf,56

²⁰http://www.oag-rks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves_549744.pdf,57

²¹http://www.oag-rks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves_549744.pdf,57

2.3.3 Firmat e Auditimit

Firmat e Auditimit (Certified public accountants firms –CPA) janë shoqëri e autorizuar për zbatimin e revezionit në mënyre profesionale dhe të pavarur. Firmat e Auditimit duhet të jenë antare të institucioneve nacionale për auditim ose të kontabilitetit të cilët perveq të tjerash kanë autorizime të shumta për mbikeqyrjen e punës së firmave të auditimit si për shembull, mbikeqyrjen për të vertetuar nese puna e kontrollit po kryhet me nivel profesional dhe nese firma përkatëse e auditimit po zbaton standartet dhe kodin e etikës profesionale të auditimit.

Në varesi të ligjeve të shtetëve të caktuara ndryshojnë edhe format e organizative të firmave të revizionit. Format kryesore të organizimit në aspektin e pronsisë janë:

- Firmat ne pronesi individuale
- Partneriteti ose ortakeria
- Shoqeria aksionare ose korporata.

Megjithate forma më e shpeshtë e organizimit të firmave të auditimit është parnteriteti (ortakeria). Nuk duhet që në të njetjën kohë dhe në të njetjën ndërmarrje ajo të kryej auditim dhe të kryej punë të tjera (p.sh të luaj rolin e keshilluesit). Firma e auditimit është plotesisht autonome dhe sillet plotesisht si të gjitha subjektet ekonomike në treg. Firma e auditimit si zbatues kryesor i kontrollit pozicionohet në mes ndërmarrjes, që është obliguese e auditit, dhe shfrytezuesit të informacioneve mbi auditimin e zbatuar.

2.3.4 Kushtet e Përgjithshme

- Auditoret e institucioneve financiare te licencuara te mbikeqyera dhe te rregulluara nga AQBK-ja duhet te aprovohen nga AQBK-ja.
- Bazuar ne aplikacionin e shkruar, AQBK-ja do te aprovoj si auditor te institucioneve financiare vetem:
- Nje auditor i licencuar ne Kosove ne pajtim me rregulloren Nr. 2001/30 mbi themelimin e Bordit Kosovar Mbi Standartet dhe Paportimin Financiar dhe regjimin

e raportimit financiar te organizatav te biznesit , dhe mbajten e antaresis ne nje shoqat profesionale te kontabilitetit ne Kosove, ose

- Nje firme auditimi te licensuar ne Kosove ne pajtim me rregulloren Nr. 2001/30 mbi themelimin e bordit kosovar mbi standartet dhe raportimin financiar dhe regjimin e raportimit financiar te organizatav te biznesit, dhe mbajten e anetarsis ne shoqaten profesionale te kontabilitetit ne Kosove. Auditoret te cilet kryejn auditimet ne emer te firmes duhet te jene auditor te licensuar ne Kosove ne pajtim me rregulloren e permenduar ne fjalin e siperme.
- Nje auditor te huaj apo nje firme te huaj te auditimit qe i ploteson kerkesat per licensim te bordit Kosovar mbi standartet dhe raportimin financiar. Ne veqanti pala e huaj duhet
- te jete ne pajtim me kerkesat per licensim te udhezimit administrativ te bordit Nr.2002/5 dhe te ndonje udhezimi vijes mbi licensim.²²

Në Kosovë operojnë shumë kompani private që kryejn shërbime të kontabilitetit, konsulences mirpo edhe të auditimit.

Disa prej tyre janë:

- Baker tilly Kosova,
- Bu & Partners,
- BDO Kosova LLC
- PwC Kosova,
- AAC Group,
- Accounting Plus,
- Comax,
- Windsor.

²²Shefket Jakupi,Fadil Krasniqi “*Auditim*”(Prishtinë 2012) f.132-133,202-203

2.3.5 Firmat e Certifikimit të Auditorëve

Në Kosovë janë disa kompani që bëjnë certifikimin e individëve në lëmi të ndryshme të sektorit financiar duke filluar nga

- Teknik i Kontabilitetit
- Kontabilist i certifikuar
- Auditor i certifikuar
- Insolvenc
- Auditor i Sektorit Publikë
- Auditor Intern

Kompanit që kryejnë këto certifikime janë

- SCAAK – ShKÇAK (Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës).
- Instituti KAF (Instituti për Kontabilitet Auditim dhe Financa).

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Auditimi është disiplinë e ndërlidhur por e ndryshme nga kontabiliteti. Auditimet financiare bëhen për të vërtetuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit, si dhe për të siguruar një vlerësim të kontrollit të brendshëm të një sistemit. Qëllimi i auditimit është të shprehim një opinion të personit organizatës sistemit në fjalë, sipas vlerësimit të bazuar në punën e bërë në bazë testimesh. Auditimi është procedurë e të vërtetuarit dhe vlerësimit të raporteve financiare dhe konsolidimit të raporteve financiare, të obliguesve të auditimit, të argumenteve dhe metodave të cilat zbatohen me rastin e përpilimit të raporteve financiare në bazë të të cilave jepet mendimi profesional dhe i pavarur mbi gjendjen reale dhe objektive financiare, rezultateve financiare dhe rrjedhës së parasë. Personat kryesorë të një kompanie janë zakonisht aksionerët e saj, por palët e tjera të tilla si organet tatimore, banka, rregullatorët, furnizuesit, klientët dhe punonjësit mund të kenë interes të dijnë se pasqyrat financiare janë prezantuar në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale. Auditori ka një përgjegjësi për të planifikuar dhe kryer auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale, shkaktuar nga gabimi apo mashtrimi. Ekzistojnë auditor të brendshëm dhe të jashtëm Auditimet financiare ekzistojnë për të shtuar besueshmërinë në pohim të nënkuptuar nga drejtuesit e një organizate që pasqyrat e saj financiare në mënyrë të drejtë të përfaqësojë pozicionin e organizatës dhe të performancës të palëve të interesuara të firmës.

4 METODOLOGJIA

Auditmi është i rëndësishem për arsyje se është proces i mbledhjes dhe krijimit të argumenteve mbi veprimtarin ekomomike dhe rezultatet me qëllim që të kostatohet baraspesha në mes raporteve të afarizmit dhe kriterjumeve. Pra Auditori është një person i avarur, profesional, i kualifikuar për të audituar pasqyrat financiare të kompanisë dhe në kete punim diplome, kam përdorur këtë metodologji.

Fillimisht po shtrojë përshkrimet se qfarë na duhet audtimit në përgjthesi, duke përdorur metodat analitike dhe empirike të interpretimit së cilat janë përgjegjesitë e auditorit .Për këtë qëllim kam shfrytezuar literaturë dhe punime editoriale në lidhje me trajtimin e veprimtarise së autorit.

5 REZULTATET

5.1 Raporti i Auditimit

Auditorët duhet të dërgojnë një raport vjetor të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me rregulloren përkatëse dhe rregullat e AQBK-së. Raporti i auditimit, duhet të konfirmoj që shërbimet e auditimit janë kryer në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore, rregullohet përkatëse dhe rregullat e AQBK-së.

Raporti i auditimit duhet të shpreh një opinion në lidhje me çështjet në vijim:

- Nëse llogarite vjetore janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standartet Nderkombetare për Raportin Financiar, rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare dhe aktiviteteve të institucionit financiar.
- Nëse menaxhmenti i institucionit financiar e ka përmbushur obligimin e tij, për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura si dhe dokumentin e informatave kontabel.
- Nëse informatat në raportin vjetor përshkruan në lidhje me llogarite vjetore, suporizmet lidhur me vazhdimësinë e operacioneve dhe propozimet në lidhje me shfrytëzimin e tepërçave apo mbulimin e humbjeve janë në pajtim me rregulloret përkatëse dhe rregullat e AQBK-së, dhe nëse informata është në pajtim me llogarite vjetore.

Nëse llogarite nuk japin informata lidhur me rezultatin dhe gjendjen e institucionit financiar e që duhet të sigurohen, auditorët duhet të theksojnë këto ose të përcaktojnë rezervat e auditoreve dhe mundësitë të sigurojnë edhe informatat të nevojshme plotëse në raportin e auditimit. Auditorët, të cilët auditojnë llogarite vjetore të kompanisë amë të institucionit financiar, duhet të sigurojnë raport të veçantë të auditimit për grupin.

7 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME

Auditorët zbuluan që përmes studimit të kontrolleve të brendshme të kompanisë ata mund të identifikonin zonat e forta e gjithashtu edhe ato të dobëta. Sa më të fuqishme kontrollet e brendshme, aq më pak testimet e balancave të llogarive të pasqyrave financiare auditorët janë të obliguar të bëjnë. Për çfarëdo llogari të rëndësishme ose për çfarëdo fazë të operacioneve financiare në të cilën kontrollet e brendshme janë të dobëta, auditorët zgjerojnë natyrën dhe shtrirjen e testeve të balancave të llogarive. Audituesit duhet të fokusohen në ato fusha ku problemet e mundshme janë më të mëdha.

6 REFERENCAT

1. Shefket Jakupi, Fadil Krasniqi "Auditim" (Prishtinë 2012)
2. Bukurije Jusufi "Auditim dhe Kontroll" ligj. (Prishtinë 2012)
3. Shefket Jakupi, Hidajet Shehu " Kontrolli dhe Revizioni i Proceseve Afariste në Ndërmarrje" (Prishtinë 2011)
4. Vjollca Karapici Ibrahim "Auditim" (Prishtinë 2009)
5. www.oag-rks.org/repository/docs/Code_of_Ethics_and_Auditing_Standards_-ONTOSAI_970836.pdf
6. http://www.oag-ks.org/repository/docs/Manuali_i_auditimit_te_Rregullise_149287.PDF
7. http://www.oag-rks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves_549744.pdf
8. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROJEKTLIGJI_PER_AUDITORIN_E_PERGJITHSHEM_DHE_ZYREN_KOMBETARE_TE_AUDITIMIT_TE_REPUBLIKES_SE_KOSOVES.pdf